



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ri-shpall këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative**

Kategoria dhe grada e vendit të punës: **Nivel drejtues, koeficienti 9**

Nr. i Referencës: **AKSP-1/2-2013**

Raporton të: **Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Planifikon, organizon dhe kontrollon infrastrukturën e teknologjisë informative në AKSP;
2. Menaxhon funksionimin e teknologjisë informative në baza ditore, zhvillon dhe kontrollon planin e TI-së në AKSP;
3. Parasheh nevojat për funksionalizimin dhe rritjen e kualitetit të shërbimeve të TI-së, mbikëqyr instalimin e serverëve dhe sigurohet se sistemi backup është në funksion dhe efektiv;
4. Identifikon nevojat e blerjes dhe implementimit të pajisjeve dhe shërbimeve të rrjetave për të plotësuar nevojat e komunikimit;
5. Zhvillon dhe implementon politikat dhe procedura e të dhënave elektronike;
6. Zhvillon dhe implementon sisteme të reja të TI-së, analizon nevojat për trajnime për staf të TI-së, me qëllim të rritjes së kualitetit të punës;
7. Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të DAP-it.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative, procedura e konkurrimit është e hapur (për gjithë të interesuarit).

Shkollimi i kërkuar

- Përgatitje Universitare – drejtimi përkatës (e obligueshme).

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri profesionale të punës në lëmin e teknologjisë informative. Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor, nën presion të punës dhe brenda afateve të kufizuara kohore. Aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike, duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin. Vetiniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor e nevojshme. Së paku pesë (5) vite përvojë pune, duke përfshi dy (2) vit përvojë punë në fushën përkatëse (e obligueshme). Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme). Njohja e gjuhës angleze (përparësi).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative, emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës). Periudha provuese 12 muaj.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 25.05.2013 deri me datën 08.06.2013.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, Ndërtesa e re administrative, ose nëpërmjet adresës elektronike: rekrutimi.aksp@rks-gov.net. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurroni.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit në numrin e tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 - 1600.